



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:284452
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05640154

Ac.nr.2/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj dhe Faton Ademi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve H. M. nga fshati G. i P., Komuna Shtime, N. H. nga fshati G. i E., Komuna Shtime, N. R. nga fshati G. i E. Komuna Shtime, E. R. nga fshati G. i E. Komuna Shtime, Xh. G. nga Lipjani, H. Rr. nga Shtimja, H. N. nga Shtimja, I. A. nga Shtimja, I. H. nga Shtimja, I. B. nga Shtimja, të cilët i përfaqëson me autorizim av. L. B. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna Shtime Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson me autorizim L. M., për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe shujtës ditore, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1431/19, të datës 21.07.2020, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 30.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa e të paditurës Komuna Shtime Drejtoria e Arsimit (DKA), NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1431/19, të datës 21.07.2020 në pikën I (një) dhe II (dy) të dispozitivit, në pjesën e aprovuar të kërkesëpadsisë së paditësve H. M., N. H., N. R. E. R., H. Rr., H. N., I. A., I. H. dhe I. B. përkitazi me kompensimin e shpërblimit jubilar, ashtu që për këtë pjesë gjykohet si në vijim: REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadsia e paditësve me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Shtimes, Drejtoria Komunale e Arsimit që në emër të shpërblimit jubilar dhe atë: paditësi H. M. në emër të shpërblimit jubilar për mbi 20 vite përvojë pune t’ia kompensojë në vlerë të 75 % të një page bazë, shumën prej 315,75 €, paditësi N. H., në emër të shpërblimit jubilar për mbi 30 vite përvojë pune t’ia kompensojë në vlerë të 100 % të një page bazë, shumën prej 405,00 €, paditësi N. R., në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite përvojë pune t’ia kompensojë në vlerë të 50 % të një page bazë, shumën prej 202,50 €, E. R., në emër të shpërblimit jubilar për mbi 30 vite përvojë pune t’ia kompensojë në vlerë të 100 % të një page bazë, shumën prej 405,00 €, H. Rr., në emër të shpërblimit

jubilar për mbi 30 vite përvojë pune t'ia kompensojë në vlerë të 100 % të një page bazë, shumën prej 317,59 €, paditësi H. N. në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite përvojë pune t'ia kompensojë në vlerë të 50 % të një page bazë, shumën prej 192,38 €, paditëses I. A., në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite përvojë pune t'ia kompensojë në vlerë të 50 % të një page bazë, shumën prej 202,50 €, paditësit I. H., në emër të shpërblimit jubilar për mbi 40 vite përvojë pune t'ia kompensojë në vlerë të 150 % të një page bazë, shumën prej 607,50 € dhe paditëses I. B., në emër të shpërblimit jubilar për mbi 20 vite përvojë pune t'ia kompensojë në vlerë të 75 % të një page bazë, shumën prej 283,50 €.

II. REFUZOHET pjesërisht e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna Shtime, Drejtoria e Arsimit (DKA), ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1431/19, të datës 21.07.2020, në pikën I (një) dhe II (dy) të dispozitivit me të cilën është *detyruar* e paditura Komuna e Shtimes, Drejtoria Komunale për Arsim që paditësve H. M., N. H., N. R. E. R., Xh. G., H. R., H. N., I. A., I. H. dhe I. B. në emër të kompensimit për ushqim për ditët e pranisë në punë, t'iu kompensojë shumat e aprovuara si në dispozitiv si dhe paditësit Xh. G., në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite përvojë pune t'ia kompensojë në vlerë të 50 % të një page bazë, shumën prej 202,50 € dhe paditësit I. H. në emër të shpërblimit jubilar për mbi 40 vite përvojë pune t'ia kompensojë në vlerë të 150 % të një page bazë, shumën prej 607,50 € si dhe në pikën III (tre), VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1431/19, të datës 21.07.2020, ka vendosur si vijon: I. APROVOHET në tërësi kërkesëpapia e paditësve H. M. nga fshati G. i P. Komuna Shtime, N. H. nga fshati G. i E. Komuna Shtime, N. R. nga fshati G. i E. Komuna Shtime, E. R. nga fshati G. i E. Komuna Shtime, Xh. G. nga Lipjani, H. Rr. nga Shtimja, H. N. nga Shtimja, I. A. nga Shtimja, I. H. nga Shtimja, I. B. nga Shtimja, si e bazuar. II.DETYROHET e paditura Komuna Shtime Drejtoria e Arsimit, që paditësve në emër të pagesës së ushqimit dhe Shpërblimit jubilar t'ia paguaj dhe atë - Paditësit H. M. nga fshati G. i P., Komuna Shtime në emër të ushqimit shumën prej 926 €, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 463 ditë kurse për shpërblim jubilar 75 % e një page bazë shumën prej 315.75 €, apo gjithsejtë shumën prej 1,241.75 € (një mijë e dyqind e katërdhjetë e një euro e shtatëdhjetë e pese cent). Paditësit N. H. nga fshati G. i E., Komuna Shtime në emër të ushqimit shumën prej 946 €, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 473 ditë kurse për shpërblim jubilar 100 % e një page bazë shumën prej 405 €, apo gjithsejtë shumën prej 1,351 € (një mijë e treqind e pesëdhjetë e një euro). Paditësit N. R. nga fshati G. i E. Komuna Shtime në emër të ushqimit shumën prej 982 €, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 491 ditë kurse për shpërblim jubilar 50 % e një page bazë shumën prej 202.50 €, apo gjithsejtë shumën prej 1,184.50€ (një mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër euro e pesëdhjetë cent). Paditësit E. R. nga fshati G. i E. Komuna Shtime në emër të ushqimit shumën prej 988 €, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 494 ditë kurse për shpërblim jubilar 100 % e një page bazë shumën prej 405 €, apo gjithsejtë shumën prej 1,393 € (një mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre euro). Paditësit Xh. G. nga fshati Lipjani në emër të ushqimit shumën prej 830 €, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me

datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 415 ditë kurse për shpërblim jubilar 50 % e një page bazë shumë prej 202.50 €, apo gjithsejtë shumë prej 1,032.50€ (një mijë e tridhete e dy euro e pesëdhjetë cent). Paditësit H. Rr. nga Shtimja në emër të ushqimit shumë prej 1,072 €, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 536 ditë kurse për shpërblim jubilar 100 % e një page bazë shumë prej 317.59 €, apo gjithsejtë shumë prej 1,389.59 € (një mijë e treqind e tetëdhjetë e nënte euro e pesëdhjetë e nëntë cent). Paditësit H. N. nga Shtimja në emër të ushqimit shumë prej 1,066 €, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 533 ditë kurse për shpërblim jubilar 50 % e një page bazë shumë prej 192.38 €, apo gjithsejtë shumë prej 1,258.38 € (një mijë e dyqind e pesëdhjetë e tete euro e tridhjetë e tete cent). Paditësit I. A. nga Shtimja në emër të ushqimit shumë prej 1,044 €, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 522 ditë kurse për shpërblim jubilar 50 % e një page bazë shumë prej 202.50 €, apo gjithsejtë shumë prej 1,246.50 € (një mijë e dyqind e katërdhjetë e gjashte euro e pesëdhjetë cent). Paditësit I. H. nga Shtimja në emër të ushqimit shumë prej 1,062 €, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 531 ditë kurse për shpërblim jubilar 150 % e një page bazë shumë prej 607.50 €, apo gjithsejtë shumë prej 1,669.50 € (një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e pesëdhjetë cent). Paditësit I. B. nga Shtimja në emër të ushqimit shumë prej 1,072 €, për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, në kohëzgjatje prej 536 ditë kurse për shpërblim jubilar 75 % e një page bazë shumë prej 283.50 €, apo gjithsejtë shumë prej 1,355.50€ (një mijë e treqind e pesëdhjetë e pese euro e pesëdhjetë cent). III. DETYROHET e paditura që shumat e përcaktuara sikurse në pikën II të dispozitivit të paguaj paditëses me kamat ligjore prej 8% nga data 21.07.2020, deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 1,194€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura përmes përfaqësuesit të saj, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta anulojë dhe çështjen t'ia kthej të njëjtës gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje apo ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësve.

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre kanë paraqitura përgjigje në ankesë përmes së cilës i kanë kundërshtuar pretendimet ankimore të të paditurës me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pathemeltë ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet si dhe të detyrohet e paditura që në emër të përpilimit të përgjigjes në ankesë t'i paguajë shumë prej 624,00 €.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- *Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.*

Nga shkresat e lëndës rezultojn se paditësit përmes të autorizuarit të tyre, me datë 03.02.2020, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi, për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe shujtës ditore, kundër të paditurës, me pretendimet se të njëjtit janë të punësuar tek e paditura, përkatësisht në SHFMU “Emin Duraku” në Shtime, si mësimdhënës klasor dhe se në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit, të njëjtëve u takon kompensimi për shpërblim jubilar për përvojën e punës si dhe kompensimi për ushqim për ditët e pranisë në punë (më detajisht si në padi në shkresa të lëndës). Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor dhe shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1431/19, të datës 21.07.2020, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjyimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se “ se nuk ishte kontestuese në mesë palëve ndërgjyqëse se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe nga data 18.04.2017 kur dhe ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive deri me datën 11.03.2020, kanë qenë në vendin e punës, respektivisht është vërtetuar prezenca e tyre në vendin e punës në ditët e precizuara, nuk ishte kontestuese edhe lartësia e kërkesëpadisë por kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë se a i takojnë paditësve shumatat e kërkuara. Gjykata e shkallës së parë deri të vendosja si në dispozitiv edhe pas administrimit të provave dhe atë Kontratat e punës për paditësit H. M., N. H., N. R., E. R., Xh. G.; N. R.; Vërtetim me E. R.; Vërtetim me numër 171 i dt.02.06.2015 për E. R.; Vërtetim me numër 1/309 i dt.08.11.2019 për Xh. G.; Vërtetim me numër 2713 i dt.02.06.2015 për Xh. G. Vërtetim me numër 232/5 i dt.06.05.2015 për Xh. G.; Vërtetim me numër 1/282 i dt.07.11.2019 për N. H.; Vërtetim me numër 417/2 i dt.16.09.2013 për H. M.; Vërtetim me numër 1/283 i dt.07.11.2019 për H. M.; Vërtetim me numër 1/285 i dt.07.11.2019 për N. R.; Vërtetim me numër 341/2 i dt.03.04.2013 për N. H.; Përgjegjja në padi e datës 09.06.2020; Vërtetim me numër 1/375 i dt.27.02.2020 për H. M.; Vërtetim me numër 1/364 i dt.27.02.2020 për N. H.; Vërtetim me numër 1/362 i dt.27.02.2020 për N. R.; Vërtetim me numër 1/365 i dt.27.02.2020 për E. R.; Vërtetim me numër 1/377 i dt.27.02.2020 për Xh. G. Padi C.nr.225/20 e dt.03.02.2020; Kontrata e punës për H. Rr.; Kontrata e punës për H. N.; Kontrata e punës për I. A.; Kontrata e punës për I. H.; Kontrata e punës për I. B.; Vërtetim me numër 977 i dt.08.11.2019 për H. Rr.; Vërtetim me numër 117/3 i dt.18.11.2019 për H. N.; Vërtetim me numër 02/853 i dt.22.03.2018 për H.N.; Vërtetim me numër 946 i dt.08.11.2019 për I. A.; Vërtetim me numër 1105/1 i dt.13.11.2019 për I. A., Vërtetim me numër 945 i dt.08.11.2019 Për I. H.; Vërtetim me numër 846 i dt.17.03.2015 për I. H.; Vërtetim me numër 02/472 i dt.24.03.2015 për I. H.; Vërtetim me numër 952 i dt.08.11.2019 për I. B.; Bëhet shikimi në listat e pagave; Përgjegjja në padi e datës 11.06.2020; Vërtetim me numër 1067/1 i dt.24.06.2020 për H. Rr.; Vërtetim me numër 111/3 i dt.22.06.2020 për H. N.; Vërtetim me numër 1072/1 i dt.24.06.2020 për I. A.; Vërtetim me numër 1070/1 i dt.24.06.2020 për I. H.; Vërtetim me numër 1071/1 i dt.24.06.2020 për I. B..”

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit, nenit 35 paragrafi 7 dhe 8, pika 8.1 dhe 8.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Lidhur me shpenzimet e procedurës i është referuar dispozitave ligjore nga neni 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore sepse dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë edhe me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare, qoftë për themelësinë e kërkesëpadsisë por edhe lartësinë e saj, ku në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar qartë mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Gjykata e Apelit, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar. Nuk mund të pranohet pretendimi për këtë shkelje sepse pjesa e ndryshuar e aktgjykimit ka të bëjë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale e jo me arsyetimin e gabuar. Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë e ka paracaktuar edhe arsyetimin e aktgjykimit për kompensimin e pagës jubilarë në atë mënyrë që përfundimi meritator është arsyetuar në përputhje me dispozitat e LPK-së, pavarësisht se një përfundim të tillë të gjykatës së shkallës së parë, gjykata ankimore e ka ndryshuar në një pjesë.

Në këtë rast gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 35 paragrafi 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 kur paditësve u ka njohur të drejtën për kompensimin e shpërblimit jubilar, me të cilën shprehimisht parashihet se: *“Punëtorët (anëtar të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i tyre i fundit, për 10 vjet të përvojës së punës, në vlerë të 50% të një page bazë, për 20 vjet të përvojës së punës, në vlerë të 75 % të një page bazë, për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë dhe për 40 vjet të përvojës së punës, në vlerë të 150 % të një page bazë”*. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuari ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse.” Kjo dispozitë përcakton të drejtën e punëtorit për shpërblim jubilar, mirëpo në rastin konkret themelësia e kësaj pjese të kërkesëpadsisë nuk ka mundur të mbështetet në këtë dispozitë për shkak se në rastin konkret paditësve e drejta për të kërkuar kompensimin e pagës jubilarë nga e paditura u ka takuar

në periudhën kur kjo kontratë nuk ka qenë në fuqi, përkatësisht paditësi H. M. vitin jubilar të përvojës së punës prej 20 viteve e ka arritur në vitin 2012, e kjo sipas Vërtetimit me nr.417/2, të datës 16.09.2013, lëshuar nga e paditura SHFMU “Emin Duraku” si dhe Vërtetim me nr.1/283, i datës 7.11.2019, nga i cili vërtetim rezulton se paditësi ka gjithsej 25 (njëzet e pesë) vite të përvojës së punës. Paditësi N. H. vitin jubilar të përvojës së punës prej 20 viteve e ka arritur në vitin 2014, e kjo sipas Vërtetimit me nr.1/282 të datës 7.11.019, lëshuar nga e paditura SHFMU “Emin Duraku”, nga i cili vërtetim rezulton se paditësi ka gjithsej 25 (njëzet e pesë) vite të përvojës së punës. Paditësi N. R. vitin jubilar të përvojës së punës prej 10 viteve e ka arritur në vitin 2012, e kjo sipas Vërtetimit me nr.2121/15, të datës 06.05.2015, lëshuar nga e paditura SHFMU “Emin Duraku” si dhe Vërtetim me nr.1/285, i datës 7.11.2019, nga i cili vërtetim rezulton se paditësi ka gjithsej 13 (trembëdhjetë) vite të përvojës së punës. Paditësi E. R. vitin jubilar të përvojës së punës prej 30 viteve e ka arritur në vitin 2011, e kjo sipas Vërtetimit me nr.171, të datës 02.06.2015, lëshuar nga e paditura SHFMU “Emin Duraku” si dhe Vërtetim me nr.1/283, i datës 7.11.2019, nga i cili vërtetim rezulton se paditësi ka gjithsej 25 (njëzet e pesë) vite të përvojës së punës ndërsa nga lista e pagave rezulton se i njëjti ka gjithsej 37 vite përvojë pune mirëpo sipas vërtetimeve të prezantuara viti jubilar nuk është arritur gjatë kohës sa ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës. Paditësi H. Rr., vitin jubilar të përvojës së punës prej 30 viteve e ka arritur në vitin 2011, e kjo sipas Vërtetimit me nr.977, të datës 08.11.2019, lëshuar nga e paditura SHFMU “Emin Duraku”, nga i cili vërtetim rezulton se paditësi ka gjithsej 38 (tridhjetetë) vite të përvojës së punës. Paditësi H. N., vitin jubilar të përvojës së punës prej 10 viteve e ka arritur në vitin 2014, e kjo sipas Vërtetimit me nr.02/853, të datës 22.03.2018, lëshuar nga e paditura SHFMU “Emin Duraku” si dhe Vërtetim me nr.117/3, i datës 18.11.2019, nga i cili vërtetim rezulton se paditësi ka gjithsej 15 (pesëmbëdhjetë) vite të përvojës së punës. Paditësja I A. vitin jubilar të përvojës së punës prej 10 viteve e ka arritur në vitin 2011, e kjo sipas Vërtetimit me nr.1105/1, të datës 13.11.2019, lëshuar nga e paditura SHFMU “Emin Duraku” si dhe Vërtetim me nr.946, i datës 08.11.2019, nga i cili vërtetim rezulton se paditësi ka gjithsej 13 (trembëdhjetë) vite të përvojës së punës. Paditësja I. B. vitin jubilar të përvojës së punës prej 10 viteve e ka arritur në vitin 2016, e kjo sipas Vërtetimit me nr.952, të datës 08.11.2019, lëshuar nga e paditura SHFMU “Emin Duraku”. Në këto periudha kur paditësit e kanë mbushur jubileun, nuk ka pasur kontratë kolektive në fuqi, andaj nuk ka bazë ligjore për të kërkuar kompensim, pra në rastin konkret nuk është me rëndësi shumë periudha kur është kërkuar pasi çështje paraprake është se a ka pasur në fuqi kontratë kolektive në kohën e përmbushjes së kushtit për kompensim të pagës jubilarë. Meqenëse në vitet e lartëcekura kur paditësit kanë arritur jubileun, ka munguar baza ligjore, kërkesëpadija e të njëjtëve është e pa bazuar, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata vendosi që të ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Në rastin konkret edhe sikur të ekzistonte baza ligjore për të kërkuar kompensim, pra sikur të kishte qenë në fuqi kontrata kolektive në vitet e cekura, kur paditësit e kanë plotësuar kushtin pra përmbushja e jubileut, nga ajo kohë e deri në paraqitjen e padisë kanë kaluar më tepër se 3 vite sikurse përcaktohet me nenin 87 të Ligjit të Punës dhe padia e tillë është e paraqitur pas afatit ligjor. Prandaj, nga arsyet e theksuara gjykata ankimore duke vlerësuar se kërkesëpadija e paditësve për shpërblim jubilar nuk ka bazë ligjore, me referim në dispozitën e nenit 195, paragrafi 1 pika e), lidhur me nenin 201, paragrafi 1, pika d) të LPK-së vendosi që aktgjykimin në pjesën përkatëse ta ndryshoj me refuzimin e kërkesëpadiës.

Gjykata e Apelit të Kosovës, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi pasi që nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në konstatimin e gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, ngase Gjykata e Apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, me provat e administruara dhe drejtë ka vendosur kur paditësve Xh. G. dhe I. H. u ka njohur të drejtën për shpërblim jubilar pasi që paditësi Xh. G. vitin jubilar vitin jubilar prej 10 viteve e ka arritur në vitin 2018 ndërsa paditësi I. H. vitin jubilar prej 40 viteve e ka arritur po ashtu në vitin 2018 ashtu që kërkesëpadia e tyre sipas nenit 35 paragrafin 8 pika 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës përcaktohet se: *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë 8.1. për 10 vjet të përvojës në vlerë të 50 % të një page bazë...”* është e bazuar.

Po ashtu lidhur më kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë për të gjithë paditësit, gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë meritore pasi që sipas vërtetimit me nr.1/375 e datës 27.02.2020 lëshuar nga Drejtoria e SHFMU “Hasan Prishtina” në G. Komuna Shtime, konstatohet se paditësi H. M. ka qenë në vendin e punës nga data 18.04.2017 e gjer më 11.03.2020 për gjithsej 463 ditë pune dhe kjo provohet përmes Vërtetimit me nr. protokollit 1/375, të datës 27.02.2020, paditësi N. H. ka qenë në vendin e punës nga data 18.04.2017 e gjer më 11.03.2020 për gjithsej 473 ditë pune dhe kjo provohet përmes Vërtetimit me nr. protokollit 1/364, të datës 27.02.2020, paditësi N. R. ka qenë në vendin e punës nga data 18.04.2017 e gjer më 11.03.2020 për gjithsej 491 ditë pune dhe kjo provohet përmes Vërtetimit me nr. protokollit 1/362, të datës 27.02.2020, paditësi E. R. ka qenë në vendin e punës nga data 18.04.2017 e gjer më 11.03.2020 për gjithsej 494 ditë pune dhe kjo provohet përmes Vërtetimit me nr. protokollit 1/365, të datës 27.02.2020, paditësi Xh. G. ka qenë në vendin e punës nga data 18.04.2017 e gjer më 11.03.2020 për gjithsej 415 ditë pune dhe kjo provohet përmes Vërtetimit me nr. protokollit 1/377, të datës 27.02.2020, paditësi H. Rr. ka qenë në vendin e punës nga data 18.04.2017 e gjer më 11.03.2020 për gjithsej 536 ditë pune dhe kjo provohet përmes Vërtetimit me nr. protokollit 1067/1, të datës 24.06.2020, paditësi H. N. ka qenë në vendin e punës nga data 18.04.2017 e gjer më 11.03.2020 për gjithsej 533 ditë pune dhe kjo provohet përmes Vërtetimit me nr. protokollit 111/3, të datës 22.06.2020, paditësja I. A. ka qenë në vendin e punës nga data 18.04.2017 e gjer më 11.03.2020 për gjithsej 522 ditë pune dhe kjo provohet përmes Vërtetimit 1072/1, të datës 24.06.2020 lëshuar nga SHFM “Emin Duraku” Shtime, paditësi I. H. ka qenë në vendin e punës nga data 18.04.2017 e gjer më 11.03.2020 për gjithsej 531 ditë pune dhe kjo provohet përmes Vërtetimit me nr.1070/1, të datës 24.06.2020 si dhe paditësja I. B. ka qenë në vendin e punës nga data 18.04.2017 e gjer më 11.03.2020 për gjithsej 536 ditë pune dhe kjo provohet përmes Vërtetimit 1071/1, të datës 24.06.2020. Po ashtu nga Kontratat e punës të prezantuara si në shkresa të lëndës vërtetohet fakti se paditësit janë të punësuar tek e paditura si mësues klasor siç vërtetohet edhe lartësia e pagave të të njëjtëve përmes Listës së Pagave bashkangjitur në shkresa të lëndës.

Prandaj në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar dispozitat ligjore lidhur me kompensimin për ushqim për ditët e pranisë në punë, të përcaktuara në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, përkatësisht nenin 35 paragrafi 7, të kësaj kontrate, në të cilin është paraparë se *“të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditë e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, 4 është 2 (dy) Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore.*

Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensim për ushqim”.

Gjykata e Apelit vlerëson se pa dyshim kërkesëpadia e paditësve është pra pjesërisht e bazuar dhe se po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se “ Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes*“. Me paragrafin 5 përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...*”.

Nga ana tjetër, pretendimi të cilin e ka theksuar e paditura në ankesë se nuk ka buxhet për këtë lloj kompensimi për punëmarrësit e saj sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk qëndron pasi që në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë. Këto situata, eventualisht të disfavorshme për të paditurën nuk mund ti rregulloj as gjykata e as paditësja, si punëmarrëse, e po ashtu kontratat e përgjithshme kolektive mund të parashohin më shumë të drejta për punëmarrësit, përtej ligjeve në fuqi, por në asnjë mënyrë nuk mund të jenë më të disfavorshme për punëdhënësit duke paraparë më pak të drejta se ato që parashihen me ligjet në fuqi.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarrja në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së. Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prandaj nga arsyet e theksuara gjykata ankimore vlerëson se kërkesëpadia e paditësve për shpërblim jubilar nuk ka bazë ligjore, e me referim në dispozitën e nenit 195, paragrafi 1 pika e), lidhur me nenin 201 paragrafi 1, pika d) të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
Ac.nr.2/2021, më datë 30.04.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj